



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -IX- TË RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRISË, MBAJTUR MË 25 TETOR 2018**

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:15.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri: Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi, Ermal Lahu, Fakte Dushi, Fatmire Saraçi, Faton Shabani, Fjolla Ujkani, Gentiana Rama, Gresa Muli, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latifi, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Qerim Selimi, Rrezarta Krasniqi, Sadije Bajgora, Safet Idrizi, Sami Istrefi, Shkëlzen Feka, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Mungoi: Shpëtim Zhegrova, Miljan Bojković dhe Lutfi Bilalli.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe nënkryetari i komunës – z.Besim Muzaqi, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se ka shumicë për punë dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - paraqiti vërejtje sa i përket vonesave në dërgimin e materialeve dhe shtoi se është bërë një praktikë jo e mirë ku shumë pika të rendit të ditës sillen në kuvend pa kaluar nëpër Komitetin për Politikë dhe Financa. Përkundër vërejtjeve shprehu se e përkrah këtë rend të ditës me propozimin që propozim-vendimi për ndarjen e çmimit “Emblema e Vushtrisë” të vendoset si pikë e parë e rendit të ditës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - paraqiti vërejtje lidhur me mënyrën e udhëheqjes së mbledhjes nga ana e kryesuesit të kuvendit për faktin se kryesuesi nuk është duke e respektuar rregulloren e punës së kuvendit. Në mbështetje të rregullores së kuvendit, është obligim i kryesuesit që të pyes anëtarët e kuvendit që a kanë diskutime para aprovimit të rendit të ditës për temat që lidhen për rend të ditës dhe jashtë rendit të ditës dhe kjo nuk po respektohet nga ana e kryesuesit të kuvendit, si dhe kjo paraqet shkelje të obligimeve që dalin nga rregullorja e punës së kuvendit. Pastaj shtoi se mbledhjen e kaluar ka pasur momente jo të këndshme dhe përplasje në kuvend, të cilat nuk do të ndodhnin sikur të kishte pasur menaxhim më të mirë të mbledhjes së kuvendit. Në kontekst të respektimit të rregullores, askush nuk ka të drejtë ta marrë fjalën disa herë për një pikë të rendit të ditës qoftë ai edhe kryetari i komunës, nuk ka të drejtë dikush të diskutojë sa herë që diçka i bie ndërmend. Askush nuk ka të drejtë që gjatë shqyrtimit të një pike të rendit të ditës të mbajë fjalime politike, por duhet të fokusohet në temën që është objekt i shqyrtimit, kushdo që nuk i përmbahet rregullave, kryesuesi duhet t’ia ndërprejë fjalën qoftë ai kryetari i komunës apo anëtar i kuvendit. Për këtë kryesuesi duhet të

ketë guxim dhe vetëm kështu do të ketë rregull dhe mbarëvajtje të punës së kuvendit, dhe gjithsesi kështu do të ruhet dinjiteti i anëtarëve të kuvendit dhe drejtorëve të drejtorive komunale. Lidhur me këto vlerësoi se opozita nuk e ka synim bllokimin e punës së kuvendit, por forma si po udhëhiqet kuvendi është jo në rregull dhe publikisht kërkoi nga kryesuesi që të marrë rregulloren dhe t'i shikojë përgjegjësitë që dalin nga ajo dhe përfundimisht t'i respektojë ato. Fakti i shmangies nga diskutimi dhe mohimi i të drejtës së anëtarit të kuvendit që të diskutojë jashtë rendit të ditës, si dhe tendenca e kryesuesit që të intereferojë në korigjimin e mendimit të anëtarit të kuvendit paraqet shkelje të rregullores, dhe fundi i fundit për t'ia korigjuar dikujt mendimin duhet pasur kapacitet, gjë e cila i mungon kryesuesit të kuvendit.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit - përsëriti pyetjen e tij se përse nuk ka përgjegjës te mjeku në vaksinim në Qendrën e mjekësisë familjare, përpos një infermiere e cila nuk e merr përgjegjësinë nëse gjatë vaksinimit të ndonjë pacienti mund të ketë ndonjë komplikim për këtë ka marrë përgjigje nga Drejtoria e Shëndetësisë, por kjo përgjigje ka qenë e mangët. Një përgjigje tjetër ka marrë nga përgjegjësi i sektorit publik të mjekësisë z.Safet Idrizi e cila nuk është përfshirë në procesverbal të mbledhjes së kaluar. Duke iu referuar përgjigjes së drejtorisë ku është njoftuar se njësia e imunizimit dhe vaksinimit udhëhiqet nga kryeinfermierja Xhevrije Kuqi, imunizimi dhe vaksinimi në kuadër të kujdesit parësor shëndetësor kryhet në disa qendra të mjekësisë familjare, prandaj është e pamundur që për secilën qendër të caktohet nga një përgjegjës për vaksinim, pasi numri i mjekëve është i kufizuar, dhe për emërimin e këtyre përgjegjësve ka implikime buxhetore, si dhe kërkon ndryshim të rregullores për sistematizimin e vendeve të punës dhe se një praktikë e tillë nuk haset në asnjë prej komunave të Republikës së Kosovës, por në çdo qendër ku kryhet shërbimi i vaksinimit, kemi mjekë që përpos pacientëve tjerë angazhohen edhe në imunizim në bashkëpunim me infermierët përgjegjës. Andaj lidhur me të gjitha këto pyetja e tij është: pse pacientët nuk kanë marrë shërbime nga mjeku i cili ka figuruar në orar të punës, pse një krim të cilin e ka bërë qeverisja e kaluar, tani këtë krim po e vazhdon Drejtoria e Shëndetësisë.

Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS-së – sqaroi se përgjigja e drejtorisë për anëtarin e kuvendit z.Përçuku ka qenë e kompletuar, por ndoshta ai nuk ka mundur ta shpreh atë që e ka menduar. Në përgjigjen e tij kishte sqaruar se përgjegjës i vaksinimit në Qendrën e mjekësisë familjare 1, është specialisti i mjekësisë familjare z.Safet Idrizi, pastaj sektori i vaksinimit ndahet në imunizim dhe vaksinim dhe funksionon në shumicën e QMF-ve. Mandej vlerësoi se kemi një rezultat të mirë të përfshirjes së fëmijëve në vaksinim dhe kjo nuk është lëvdatë, por është vlerësim i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik që është kupola e vlerësimit të shëndetit publik në Republikën e Kosovës. Mandej përsëriti se përgjegjësi i vaksinimit është përgjegjësi i sektorit të shëndetit publik e që është Dr. Safet Idrizi, i cili vlerësoi se e kryen punën me profesionalizëm dhe kompetencë, duke e respektuar orarin e punës, ndërsa sa i përket vaksinimit njoftoi se përgjegjëse është znj. Xhevrije Kuqi. Në këtë kontekst drejtoria ka dhënë përgjigje institucionale konform gjendje faktike, kurse nëse anëtari i kuvendit aludon në ndonjë doktor tjetër që nuk e ka kryer punën si duhet, atëherë duhet ta potencojë emrin e atij doktori.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit - pyeti se përse qytetarët nuk marrin shërbim shëndetësor nga mjeku i cili ka qenë në orar të punës dhe përse pas ankesës që i ka bërë atij mjeku i është ndërruar vendi i punës.

Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS-së – tha se anëtari i kuvendit z. Përçuku, aludon se nuk ka marrë shërbim mjekësor nga Dr. Fehmi Haxha për të cilin njoftoi se vuan nga sëmundja parkinson një sëmundje kjo e rëndë. Tutje shtoi se duke u mbështetur në dispozitat e kontratës kolektive ku në nenin 16, paragrafi 6 thuhet: i punësuari me sëmundje të rëndë shëndetësore ka të drejtë pushimi mjekësor në ditë të pacaktuara kohore dhe në këtë bazë ligjore zyra ligjore e QKMF-së përmes Drejtorisë së Shëndetësisë i ka kërkuar këshillë juridike

Departamentit Ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë për këtë çështje dhe përgjigja e tyre është: në bazë të dispozitës së lartëshënuar i punësuar realizon pushim mjekësor në këtë fazë të sëmundjes nëse e dëshmon me raport mjekësor në kohëzgjatje në ditë të papërcaktuara kohore. Andaj lidhur me këto vlerësoi se Ministria e Shëndetësisë është autoritetit që e interpreton këtë kontratë dhe drejtorja është e obliguar që ta zbatojë kontratën kolektive, andaj mbi këtë bazë ka ndodhur ndryshimi i vendit të punës për mjekun në fjalë.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit - sqaroi se sektori i shëndetit publik funksionon në kuadër të Departamentit të Mjekësisë Familjare, në sektorin e shëndetit publik janë dy njësi: Njësia e vaksinimit-imunizimit dhe Njësia e sistemit informator shëndetësor, ndërsa pozita e tij është shef i sektorit të shëndetit publik në kuadër të Departamentit të mjekësisë familjare. Njësia e vaksinimit sipas konceptit të mjekësisë familjare funksionon në qendrat e mjekësisë familjare dhe në QKMF, përgjegjës për vaksinimin është mjeku që punon nëpër këto qendra, ndërsa duke iu referuar anëtarit të kuvendit z.Përçuku pyeti se për çfarë krimi bëhet fjalë për të cilin ai deklaroi dhe i adreson qeverisë së kaluar.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit - ceku se mjeku që ka shërbyer në njësinë e vaksinimit për 5 vite më radhë nuk ka ofruar shërbime shëndetësore edhe pse ka vazhduar me marrëdhënien e punës dhe kjo është kundërligjore. Kurse tash së fundi atij i është ndërruar vendi i punës.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit - përsëriti se në mbledhjen e kaluar kishte kërkuar një përgjigje nga Drejtorja e Arsimit, lidhur me procedurat e konkursit për punësimin e mësimdhënësve në institucione të ndryshme arsimore, por për këtë nuk kishte marrë përgjigje, andej pyeti se deri ku kanë shkuar këto procedura.

Ymer Hardinaj, anëtar i kuvendit - njoftoi se Këshilli i fshatrave Stanoc i Poshtëm, Stanoc i Epërm, Lumadh dhe Gracë, kanë mbajtur një marsh protestues në mbështetje të familjarëve të viktimave që kanë humbur jetën në rrugën në fshatin Stanoc në drejtim të Prishtinës. Pas kësaj në kuadër të një takimi me ministrin e Ministrisë së Infrastrukturës Pal Lekaj, i kanë parashtruar disa kërkesa për këtë ministri dhe për këtë kanë marrë premtimin se këto kërkesa brenda një kohe shumë të shkurtër do të merren për bazë. Këto kërkesa kryesisht konsistojnë në ndriçimin publik të asaj rruge, do të bëhet pastrimi dhe funksionalizimi i nënkalimit, dhe gjithashtu do të vendosen barrierat që këmbësorëve t'u pamundësohet kalimi i parregullt i asaj rruge.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - propozoi që pronarëve të shtëpive që në vitet e 90-ta shtëpitë e tyre i lëshuan dhe i bënë shkolla t'u ndahet mirënjohje nga Drejtorja e Arsimit, kjo për faktin se këta pronarë treguan një patriotizëm të lartë, duke mos u pajtuar me sistemin e masave të dhunshme të Millosheviqit. Pastaj më këto shtëpi të vendoset nga një pllakë me mbishkrimin se në ato shtëpi është zhvilluar mësimi në kohë të okupimit serb, kjo do të ishte se si shenjë dalluese dhe në kohë do të rezistonte kujtimi për vështirësitë dhe kontributin që kanë dhënë këto familje.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit - paraqiti rendin e ditës lidhur me mbledhjen, duke prezantuar disa pika shpesh për inkuorporim në rend të ditës, në pikën në të ndryshme.

Afrim Namani, drejtor i DA-së - sqaroi se raporti lidhur me konkursin në Drejtorinë e Arsimit është pothuajse i gatshëm dhe është vetëm edhe një rast që pritet përfundimi i të drejtës së ankesës dhe ai raport do t'u ofrohet edhe anëtarëve të kuvendit. Pastaj lidhur me dhënien e mirënjohjeve për pronarët e shtëpive-shkolla njoftoi se në të kaluarën këtyre pronarëve të shtëpive iu janë dhënë mirënjohje.

Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit - tha se e mbështet propozimin e anëtarit të kuvendit z.Januzi dhe i rekomandoi drejtorit të arsimit që ky propozim të jetë për nder të 7 Marsit - Ditës së mësuesit.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit - tha se koha e rezistencës ndaj okupimit serb gjatë viteve 90-ta është reflektuar pikësepari në fushën e arsimit, duke organizuar procesin paralel arsimor

dhe kjo ka qenë një etapë e lavdishme e historisë sonë. Lidhur me pronarët e shtëpive-shkolla vlerësoi se çkado që bëjmë për ta nuk është e mjaftueshme. Më konkretisht në kontekst të kësaj çështjeje në vitin 2012 në rastin e 20 vjetorit të këtyre ngjarjeve, Drejtoria e Arsimit u kishte ndarë mirënjohje pronarëve të shtëpive-shkolla. Lidhur me vendosjen e pllakave nëpër këto shtëpi, është çështje që duhet të merremi të gjithë që kjo të bëhet për nder të 7 Marsit - Ditës së mësuesit.

Mejreme Ismajli, anëtare e kuvendit - tha se ndër shtëpitë dhe familjet që kanë kontribuar, është edhe shtëpia e Rrahman Vojvodës, shtëpia e të cilit gjatë kohës së lutës e edhe më herët është shfrytëzuar si spital ushtarako-civil deri në çlirimin e Kosovës dhe kjo familje meriton të nderohet me mirënjohje.

Abdullah Vojvoda, anëtar i kuvendit - tha se në kohë lufte ai dhe familja e tij nuk kanë kontribuar për mirënjohje, por për çlirimin e vendit, në këtë rast porositi që mos të harrohen kontributdhënësit për lirinë e Kosovës.

Në fund të diskutimeve jashtë rendit dhe për rendin e ditës kuvendit pas votimit me vota “unanime” aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 27.9.2018;
2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndarje të çmimit “Emblema e Vushtrrisë”;
3. Shqyrtimi i Planit i veprimit të menaxhmentit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëshuara në Raportin e Auditimit të Zyrës Kombëtare për Auditim-Komuna e Vushtrrisë;
4. Shqyrtimi i raportit lidhur me aktivitetet për implementim të Planit lokal pesëvjeçar të menaxhimit të mbetjeve 2016-2020, si dhe gjendjen e pastërtisë në Komunën e Vushtrrisë;
5. Shqyrtimi i Raportit lidhur me vizitat sistematike të nxënësve të klasave të para të SHFMU, të Komunës së Vushtrrisë;
6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore;
7. Shqyrtimi i Raportit janar-shtator 2018 për të hyrat dhe shpenzimet;
8. Shqyrtimi i Draft-rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2019;
9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpallje të ankandit publik;
10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës pa kompensim, KRM “Uniteti”, Sh.A. Njësia në Vushtrri;
11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin e vendimit të kuvendit Nr.115/18 i datës 26.04.2018;
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për plotësimin e vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës për Qendrën Ditore për Fëmijët me Nevoja të Veçanta në fshatin Nedakoc;
13. Shqyrtimi i propozim-vendimit për rialokimin e mjeteve financiare të Komunës së Vushtrrisë;
14. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore që evidentohet në emër të Ermira/Bedri/Osmani;
15. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore që evidentohet në emër të Mehdi Bilallit;
16. Shqyrtimi i kërkesës për rishqyrtimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me Nr.23/18 i datës 25. 01.2018 për themelimin e KPF-së;
17. Të ndryshme;

a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestininimin e mjeteve financiare të Komunës së Vushtrrisë.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 27.9.2018;

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - paraqiti vërejtje sa i përket hartimit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar, ku në faqen numër 3 të tij është konstatuar numri i votave që është vendosur lidhur me aprovimin e buxhetit të komunës, por nuk figuron vendimi që është marr në atë rast. Pastaj ai propozoi që në mbledhjet e kuvendit të vendosen kamerat ku do të bëhej video-incizimi i mbledhjes, i njëjti do mund të vendosej në faqen-zyrtare të komunës përmes një linku dhe kjo do të mundësojë që procesverbali të hartohet në formë shumë të shkurtër ashtu që do të evidentohet vetëm forma e votimit dhe vendimet që merren brenda një mbledhjeje të kuvendit.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 27.09.2018, me vërejtjen e parashtruar nga anëtari i kuvendit.

2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndarje të çmimit “Emblema e Vushtrrisë”

Melihate Basholli - Latifi, anëtare e kuvendit - fillimisht shprehu dhembjen dhe indignatën e saj për rastin në fjalë, duke shtuar se duhet ta kesh një burrë me mbiemër tjetër të një nacionaliteti tjetër për të dalë publikisht, për të dëshmuar për atë që iu ka ndodhur shumë grave dhe vajzave shqiptare gjatë luftës në Kosovë dhe në këtë kontekst vlerësoi se është hap i duhur i kryetarit të komunës për propozimin e bërë për ndarjen e këtij çmimi ku në këtë rast kërkoi që ditën që do të ndahet ky çmim të ftohen grupi i grave anëtare të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim znj. **Vasfije Krasniqi - Goodman**, e lindur në fshatin Stanoc i Poshtëm të Komunës së Vushtrrisë, e mbijetuar e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, i ndahet çmimi “Emblema e Vushtrrisë” për guximin, për thyerjen e stigmës dhe për përkrahjen e viktimave të dhunës çnjerëzore nga milicët serbë gjatë luftës së fundit në Kosovë.

2. Autorizohet Kryetari i komunës që t’ia dorëzojë këtë çmim – dekoratë të lartpërmendurës.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i komunës.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

3. Shqyrtimi i Planit i veprimit të menaxhmentit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëshuara në Raportin e Auditimit të Zyrës Kombëtare për Auditim-Komuna e Vushtrrisë;

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - përsëriti vërejtjen e tij lidhur me rekomandimin e parë tek shpenzimet për subvencione në vlerë prej 276,246 .00 €, dhe në këtë shkruan se data e përfundimit të rekomandimit evidentohet se ky rekomandim është i zbatuar dhe për këtë në mbledhjen e KPF-së është thënë se ky rekomandim ka vështirësi në zbatim.

Lutfi Gurguri, drejtor i DBF-së - sqaroi se rekomandimi i cekur nga anëtari i kuvendit mund të realizohet pjesërisht.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota unanime aprovoi Planin e veprimit të menaxhmentit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëshuara në Raportin e Auditimit të Zyrës Kombëtare për Auditim-Komuna e Vushtrrisë

4. Shqyrtimi i raportit lidhur me aktivitetet për implementim të Planit lokal pesëvjeçar të menaxhimit të mbetjeve 2016-2020, si dhe gjendjen e pastërtisë në Komunën e Vushtrrisë

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - pyeti se deri ku kemi arrit me aksionin për pastrimin e komunës sonë. Pastaj ai përsëriti kërkesën e tij lidhur me ndotjet që po ndodhin në fushën mes fshatit Pasomë dhe Banjës-Sllatinë, ku me tonelata mbetjet inerte derdhën në atë fushë dhe kjo ka bërë që ai terren të kontaminohet plotësisht. Tutje vlerësoi se si rezultat i këtyre mbeturinave është duke u mbyllur edhe rruga dhe për këtë kërkoi nga kompetentët që këto mbeturina të hiqen nga atje dhe të lirohet rruga dhe të bëhet pastrimi i asaj fushe. Në fund kërkoi nga Drejtoria e Inspektimeve që të jetë azhure në kontrolle dhe në shqiptimin e gjobave për qytetarët që hedhin mbeturina në vendet joadekuate.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se menaxhimi i mbeturinave ka qenë sfidë në vazhdimësi, por me buxhetin e vitit të kaluar janë planifikuar mjetet financiare për ofrimin e shërbimeve për mbeturina për çdo qytetar të komunës nga data 1.1.2018, dhe garantuese për implementimin e këtij projekti në bazë të planit të veprimit ka qenë Komuna e Vushtrrisë. Mirëpo megjithëkëtë zgjidhja afatgjate e këtij problemi kërkon një qasje profesionale, të përgjegjshme dhe mbi të gjitha ligjore. Lidhur me këtë problematikë ai pyeti se sa është çmimi të cilin komuna ia paguan Kompanisë “Uniteti” për shërbimin e pastrimit të mbeturinave për një ekonomi familjare, dhe për një biznes si dhe në çfarë forme, pastaj menaxhmenti komunal a është në dijeni se caktimi i çmimit për këto shërbime është kompetencë ekskluzive e kuvendit të komunës, dhe për këtë ekziston një çmimore tarifë e aprovuar nga kuvendi, dhe që sipas burimeve jozyrtare komuna është në kundërshtim të plotë me atë rregullore për caktimin e tarifave dhe rregullimit të procesit të menaxhimit të mbeturinave. Ky proces karakterizohet me jotransparencë, sepse askush nuk e di se kush është projekt-menaxher i kësaj kontrate për menaxhimin e mbeturinave dhe kush i bartë përgjegjësitë. Mandej pyeti a e dini organizimin e kompanisë “Uniteti” çfarë statusi juridik ka, sepse komuna ka marrë rolin e pronarit, komuna ka bërë emërime politike që janë në kundërshtim me ligjin, komuna nuk mund as me privatizu e as me u bë pronar i kësaj kompanie. Në fund ai kërkoi që të respektohet ligji lidhur me procesin e menaxhimit të mbeturinave dhe ofrimin e shërbimeve sa më të mira për qytetarët.

Sadat Rashica, drejtor i DSHP-së - njoftoi se është formuar një task-forcë lidhur me procesin e menaxhimit të mbeturinave, ku aktualisht është duke u bërë incizimi i gjendjes faktike të mbeturinave sa i përket deponive ilegale, në ç’ rast një deponi e tillë është eliminuar në fshatin Pestovë, ndërsa deponia në fshatin Pasomë do të eliminohet shumë shpejt. Lidhur me çmimin që paguhet për një ekonomi familjare për mbeturina ajo është 4,40 € që inkasohet nga qytetarët, kurse komuna i paguan kompanisë një shumë prej 3 €, ndërsa me bizneset inkason kompania “Uniteti”. Lidhur me këtë çështje komuna ka emëruar një zyrtar komunal si zyrtar për menaxhimin e mbeturinave, dhe drejtoria është në proces të draftimit të rregullores për mbeturina e cila shumë shpejt do të vjen në kuvend për aprovim.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit - pyeti se përse disa familje në fshatin Stanoc të Poshtëm, nuk janë evidentuar në procesin e inkasimit dhe atyre nuk iu ofrohet shërbim i menaxhimit dhe bartjes së mbeturinave.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota unanime aprovoi raportin lidhur me aktivitetet për implementim të Planit lokal pesëvjeçar të menaxhimit të mbetjeve 2016-2020.

5. Shqyrtimi i Raportit lidhur me vizitat sistematike të nxënësve të klasave të para të SHFMU, të Komunës së Vushtrrisë

Mejreme Ismajli, anëtare e kuvendit - tha se duhet të përshëndetet ekipi që është marrë me realizimin e këtyre vizitave, i cili është udhëhequr nga Dr. Idrizi dhe i cili ka bërë një punë shumë të mirë për nxënësit në evidentimin dhe ekzaminimin e këtyre nxënësve. Tutje ajo spikati mungesën e mjekëve nëpër shkolla, por edhe mungesën e psikologëve që janë shumë të nevojshëm në procesin mësimor. Gjatë këtyre kontrolleve është evidentuar kariesi i dhëmbëve shumë i madh tek nxënësit dhe për këtë kishte me qenë mirë hartimi i një plani për sensibilizimin e kësaj problematike, por gjithashtu duhet të punohet më shumë në edukimin shëndetësor të fëmijëve tanë.

Melihate Basholli -Latifi, anëtare e kuvendit - tha se raporti në fjalë është i detajuar dhe si i tillë përmes tij marrim informata të hollësishme për gjendjen shëndetësore të nxënësve të klasave të para, sipas vizitave sistematike që janë bërë gjatë vitit të kaluar. Meqë jemi në një mandat të ri, e sheh të arsyeshme ta cekë se vizitat sistematike të nxënësve kanë qenë iniciativë e Grupit të Grave Anëtare të Kuvendit dhe është realizuar nga DSHPS-ja, dhe në këtë rast falënderoi dr. Safet Idrizin, i cili jo vetëm që e ka realizuar këtë projekt, por edhe vazhdimisht ka qenë pjesë e këtij stafi për realizimin e këtyre vizitave. Më tutje ajo vlerësoi se ky projekt ka rezultuar shumë i suksesshëm në ekzaminimin e nxënësve dhe kërkoi që ky projekt të zgjerohet edhe në shërimin e atyre nxënësve që nuk kanë mundësi financiare të vazhdojnë procedurat e kurimit të mëtejme. Në këtë kontekst ajo kërkoi që vizitat e tilla të realizohen edhe për klasat tjera, ashtu që kjo të mundësojë që nëse jo për çdo vit kontrolli i nxënësve të bëhet të paktën në dy apo tri vite.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - tha se e përgëzon hartuesin, që ka bërë një raport të shkëlqyer në ç'rast janë pasqyruar në mënyrë të saktë ato që thuhet në raport. Tutje ai shtoi se nuk kemi shumë të dhëna sa i përket statistikave të nxënësve që janë me obezitet. Në mungesë të statistikave në nivel nacional lidhur me mbipeshën ai iu referua statistikave të Organizatës Ndërkombëtare të Shëndetësisë ku në raportin e vitit 2015, thuhet se mbipesha ka prekur rreth 2.2 miliardë njerëz apo rreth 30% të popullatës së botës apo 1/3 e popullatës së botës është obeze. Lidhur me këtë ai pyeti se komisioni a kanë evidentuar ndonjë nxënës që kalojnë tek pesha obeziteti i klasës së parë, klasës së dytë apo më thjesht tek indeksi i masës trupore a kemi nxënës të këtyre klasave obez që e kalojnë indeksin e masë trupore mbi 35 ose mbi 30 që kishte me shkaktuar rrezik për probleme shëndetësore, andaj nëse komisioni i ka këto statistika është mirë që këto të inkorporohen në raport.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit - tha se përpos këtyre vizitave, komuna duhet të orientohet, në dizajnimin e politikave shëndetësore, të cilat kanë drejtimin në zgjedhjen e problemeve të identifikuar. Një gjë të cilën ajo e vlerësoi si të domosdoshme është mbajtja e ligjëratave për nxënësit nëpër shkolla.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit - pyeti se komisioni a ka hasur, në sëmundje të vonuara mentale, sëmundje epileptike dhe sëmundje të sheqerit.

Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS-së – paraqiti sqarime lidhur me raportin në fjalë, duke dhënë përgjigje në pyetjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit. Në kontekst të vizitave

mjekësore të realizuara ceku se raporti i hartuar nga ana e ekipit mjekësor hedh dritë mbi statistikën e shëndetit të fëmijëve e që janë shumë të nevojshme për politikën komunale lidhur me shëndetin publik. Lidhur me sëmundjen e kariesit vlerësoi se në raport janë evidentuar si mjaft shqetësuese përmasat e kësaj sëmundjeje tek nxënësit dhe kjo gjendje është pothuajse në gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Shkaktar kryesor i kësaj sëmundjeje mund të konsiderohet stili i jetesë tek ne, e për më shumë mungesa e edukimit shëndetësor. Për këtë kishte me qenë mirë që bashkë me Drejtorinë e Arsimit në kurrikulat shkollore në mësimin zgjedhor të futen tema të edukimit shëndetësor për nxënësit. Këtë projekt për vizita sistematike mjekësore për herë të parë e kishte realizuar Komuna e Prishtinës, dhe pajtohet që ky projekt të zgjerohet edhe në kurimin e nxënësve që ekzaminohen me ndonjë sëmundje. Në fund tha se sa i përket sëmundjeve mentale nuk kanë hasur, kurse lidhur me diabetin ceku se për këtë sëmundje kërkohen ekzaminime më të hollësishme që kërkojnë analiza shpesh, por nëse haset ndonjë dyshim, atëherë rastet e tilla do të evidentohen dhe do udhëzohen për tretman të mëtejshëm.

Melihate Basholli - Latifi, anëtare e kuvendit - në kundërpërgjigje se VV-ja e kishte hartuar për herë të parë projektin e vizitave sistematike, vlerësoi se grupi i grave asambliste nuk është i vet një partie politike dhe shtoi se kur është fjala për çështje thelbësore siç është shëndeti i fëmijëve, atëherë nuk ka ngjyrimë politike.

Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit - në emër të grupit kuvendar të VV-së e përkrahi raportin e ofruar lidhur me vizitat sistematike mjekësore nëpër shkolla.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit - tha se e mbështet këtë raport si mjaft i kompletuar dhe shtoi se ky projekt nuk duhet të politizohet, sepse i njëjti ka filluar të implementohet edhe më herët në mandatin e kaluar, i mbështetur edhe nga grupi i grave anëtare të kuvendit, por ky projekt është realizuar edhe në komunat tjera. Një çështje që duhet t'i kushtohet vëmendje është ajo e shikimit të nxënësve, për faktin se shumë prej tyre kanë nevojë për syze, dhe në këto vizita duhet të përfshihet edhe oftamologu me qëllim që nxënësit që ekzaminohen me problem me shikim, të udhëzohen menjëherë për trajtim të mëtejshëm.

Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS-së – arsyetoi se ky projekt nuk dëshiron të politizohet, dhe shtoi se në fillim të mandatit e kishte përgëzuar qeverinë e kaluar që në planin e punës e kishte gjetur si temë projektin për vizitat sistematike. Lidhur me shikimin e nxënësve njoftoi se në vizitat sistematike janë bërë ekzaminime të shikimit përmes tabelës së Shenellit.

Afrim Namani, drejtor i DA-së - tha se në kuadër të lëndëve mësimore në kurrikulat shkollore, janë dy lëndë që kanë të bëjnë me edukimin shëndetësor të nxënësve dhe atë lënda e biologjisë dhe ajo e ekologjisë.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit - në përgjigjet e tij profesionale sqaroi se indeksi i masës trupore (BDMI) deri në moshën 18 vjeçare nuk ka relevancë klinike, ndërsa në raport i keni statistikën për peshë normale dhe për mbipeshë dhe është formula me të cilën llogaritet kjo komponentë. Pastaj lidhur me sëmundjen e diabetit, epilepsinë, dhe ngecjet në zhvillimin psiko-fizik, ceku se për këto janë bërë disa analiza dhe të njëjtat janë të evidentuara në raport. Mandej në swot-analizë ku janë paraqit mundësitë, dobësitë, rreziqet dhe kërcënimet gjatë zhvillimit të këtij projekti. Për këtë projekt falënderoi Drejtorinë e Shëndetësisë dhe atë të arsimit për partneritetin e treguar për realizimin e këtij projekti. Qëllimi i këtyre vizitave është identifikimi i problemeve të rastësishme shëndetësore tek nxënësit. Për fuqizimin e këtij projekti në të ardhmen kërkoi mbështetjen e Drejtorisë së Arsimit. Lidhur me sëmundjen e diabetit njoftoi se nga analizat e urinës nuk kanë hasur në ndonjë rast i cili është konstatuar me sheqer, sëmundja e epilepsisë është sëmundje kronike e cila më lehtë identifikohet, ndërsa në ngecjet të zhvillimit psiko-fizik kemi raste që janë cekur në shtojcë të raportit se çka është ekzaminuar dhe hulumtuar. Në fund tha se nuk ka shumë rëndësi se kush e ka realizuar këtë projekt, por e rëndësishme është shtyrja përpara e këtij projekti dhe identifikimi i problemeve tek nxënësit.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - kërkoi që ky raport të vendoset në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë me qëllim që qytetarët të kenë mundësi në qasjen e leximit të këtij raporti.

Abdullah Vojvoda, anëtar i kuvendit -tha se raporti është mjaft i kompletuar, porse këto vizita sistematike duhet të kompletohen edhe me mjekë tjerë siç është oftamologu, ortopedi dhe endokrinologu me qëllim që të kemi një tablo të përgjithshme dhe complete të gjendjes shëndetësore të nxënësve.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota unanime aprovoi raportin lidhur me vizitat sistematike të nxënësve të klasave të para të SHFMU, të Komunës së Vushtrrisë.

6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se për të gjitha ato që janë të shkruar në informatë e përgëzon drejtorinë kompetente, por shtoi se kryetari i komunës dhe qeveria e tij janë përgjegjësit kryesor për ruajtjen e pronës komunale. Andaj pyeti se cilët janë hapat që i ka ndërmarrë Drejtoria e Kadastrit në identifikimin e pronave të uzurpuara komunale. Lidhur me këtë problematikë vlerësoi se kemi dhjetëra prona të uzurpuara ku bëhen ndërtime dhe komuna për këto hesht. Për këtë ai kërkoi që të ndërmerren veprime konkrete nga drejtoria kompetente. Nëse këto veprime nuk ndërmerren ai në mbledhjen e ardhshme do t'ia prezantojë kuvendit numrat e ngastrave kadastrale të cilat janë të uzurpuara e për të cilat drejtoria duhet të ndërmarr veprime për lirimimin e tyre. Në këtë kontekst bëri të ditur që sukseset e një qeverie komunale në këtë rast varen nga mirëmenaxhimi i pronave komunale dhe në këtë kjo qeveri ka dështuar. Pastaj identifikimi i pronave të uzurpuara nënkupton identifikimin e numrave të parcelave, hulumtimi dhe zbulimi i shfrytëzuesëve të kundërligjshëm dhe lirimi i këtyre pronave komunale.

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së - njoftoi se gjatë periudhës janar-shtator, nuk ka pasur inicim të procedurës për lidhjen e ndonjë kontrate për dhënie e tokës bujqësore në shfrytëzim, përkundrazi në muajin mars janë bërë dy shkëputje të kontratave mes komunës dhe shfrytëzuesit Baki Haradinaj në interes të përgjithshëm në zonën kadastrale Lumadh ku në këtë pronë parashihet ndërtimi i parkut industrial të biznesit. Lidhur me inkasimin e të hyrave nga prona komunale njoftoi se inkasimi për këtë vit ka pasur rritje ashtu që për periudhën janar-shtator të këtij viti janë realizuar mbi 55,000.000 €, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ku inkasimi ishte 23,750.00 €. Sa i përket listës se mjeteve të inkasuara ajo i është bashkëngjitur informatës në fjalë dhe kjo është bërë me kërkesën e anëtarit të kuvendit Nezir Klinaku.

Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së - njoftoi se tashmë lista e pronave me të cilat menaxhon komuna, është përgatitur dhe ajo listë do të publikohet edhe në faqen zyrtare të komunës, dhe për këtë pyeti se përse një listë e tillë nuk ishte hartuar më herët. Lidhur me uzurpimin e pronave komunale ceku se po krijohet përshtypja sikur gjatë këtyre 10 muajve qeverisjeje janë bërë uzurpime pronash, por e vërteta është se këto prona kanë qenë të uzurpuara për 18 vite me radhë dhe askush nuk është marrë me këtë problematikë. Tutje siguroi se për këta muaj sa ata qeverisin nuk ka ndodhur asnjë uzurpim i pronës komunale, dhe për këtë drejtoria është duke u marrë me identifikimin e këtyre pronave. Në fund njoftoi se janë aprovuar kërkesat e komunës për kthimin e pesë pronave nën menaxhimin e komunës.

Ymer Hardinaj, anëtar i kuvendit - pyeti se a janë realizuar projektet të cilat i kanë prezantuar shfrytëzuesit e pronave komunale, për faktin se ata në momentin kur kanë kërkuar

marrjen e këtyre pronave në shfrytëzim kanë prezantuar një projekt konkret se çka dëshirojnë të realizojnë në ato prona.

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së - njoftoi se Drejtoria e Urbanizimit i menaxhon 16 kontrata lidhur me pronat nga qeveria e kaluar, dhe menaxhimi sa i përket pagesave është në masën 80%, kurse pjesën tjetër e menaxhon drejtoria tjetër kompetente, varësisht prej natyrës së projektit.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - tha se duhet të kemi informata të hollësishme se ku ndodhen pronat bujqësore komunale sepse ai dhe anëtarët e tjerë të kuvendit nuk e dinë se ku ndodhen këto prona. Mandej në informatë duhet evidentuar se sa prona komunale ka komuna, kujt i janë dhënë në shfrytëzim dhe a janë kryer pagesat për shfrytëzimin e këtyre pronave.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - tha se në informatë duhet të evidentohet edhe borxhi që kanë shfrytëzuesit e pronave komunale. Lidhur me uzurpimet ceku se ato në masë të madhe kanë filluar të bëhen në vitin 1999, e këndej, por mirë është që qeveria aktuale të fillojë të merret me lirimin e këtyre pronave komunale.

7. Shqyrtimi i Raportit janar-shtator 2018 për të hyrat dhe shpenzimet

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - tha se gjatë periudhës janar-shtator 2018 ka më pak të hyra vetanake, kurse ka më shumë shpenzime, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Sipas tij, tek <administrata dhe personeli> të hyrat e realizuara në vitin 2018 janë 58,763.00 €, kurse në vitin 2017 kemi pasur të hyra të realizuara 36,486.00 €, që do të thotë është pozitive. Për çdo lëvdatë e kemi edhe <Drejtorinë për Buxhet dhe Financa>, ku të hyrat e realizuara në vitin 2018 janë 507,583.52 €, kurse në vitin 2017 kemi pasur të hyra të realizuara 328,563.40 €.

Edhe <Drejtoria për Arsim> është pozitive, pasi që të hyrat e realizuara në vitin 2018 janë 41,862.00 €, kurse në vitin 2017 ka pasur të hyra të realizuara 37,559.25 €. Sipas Klinakut edhe <Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural> është pozitive, pasi që të hyrat e realizuara në vitin 2018 janë 27,624.92 €, kurse në vitin 2017 ka pasur të hyra të realizuara 21,427.00 €. Ndërkaq, <Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë> është më keq, pasi që të hyrat e realizuara në vitin 2018 janë 81,340.00 €, kurse në vitin 2017 ka pasur të hyra të realizuara 100,114.50 €. Tek <Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport>, është më keq në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Pra, të hyrat e realizuara në vitin 2018 janë 1,217.00 €, kurse në vitin 2017 kemi pasur të hyra të realizuara 2,073.00 €. Klinaku theksoi se <Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit> është shumë keq, pasi që të hyrat e realizuara në vitin 2018 janë 122,417.99 €, kurse në vitin 2017 ka pasur të hyra të realizuara 230,678.95 €. Ai tha se e dimë që kjo drejtori nuk mund t'i detyrojë qytetarët me dhunë me marrë leje ndërtimore. Por, është Drejtoria për Inspektime që mund t'i detyrojë qytetarët që të shkojnë në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të pajisen me leje ndërtimore. Tutje tha se tek <Drejtoria për Shërbime Publike> gjendja është më mirë pasi që të hyrat e realizuara në vitin 2018 janë 133,611.72 €, kurse në vitin 2017 ka pasur të hyra të realizuara 51,614.00 €. Sipas meje, kjo rritje është për shkak se këtë vit ka filluar të bëhet edhe pagesa e mbeturinave, si dhe <gjobat e trafikut> në vitin 2018 janë 110,985.00 €, që do të thotë se janë më të larta në raport me periudhën e njëjtë raportuese të vitit 2017 që kanë qenë 22,155.00€, kurse <gjobat e gjykatave> dhe <të hyrat tjera> janë 740.00€ me 3,7200.00€. Ai pyeti se çka nënkuptojnë <të hyrat tjera>?. Mandej tha se të hyrat vetanake në përgjithësi për këtë nëntëmujor të vitit 2018 janë 1,134,144.89€ kurse në periudhën e njëjtë raportuese për vitin 2017 kemi të hyrat vetanake 1,495,290.86€, që do të thotë se ka më pak të hyra në raport me vitin e kaluar. Ndërkaq, sa u përket shpenzimeve, ai tha se tek kategoria <mallra dhe shërbime> qeveria komunale për këtë periudhë raportuese ka shpenzuar më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë raportuese të vitit të kaluar. Po ashtu, edhe tek kategoria <shpenzime

komunale> qeveria komunale për këtë periudhë raportuese ka shpenzuar më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë raportuese të vitit të kaluar. Tek kategoria <subvencionet dhe transferet> qeveria komunale për këtë periudhë raportuese ka shpenzuar më pak krahasuar me periudhën e njëjtë raportuese të vitit të kaluar. Si përfundim, Klinaku theksoi se në vitin 2018 ka 361,145.97€ më pak të hyra vetanake krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Po ashtu, ai tha se edhe shpenzime keni mbi 300 mijë euro më shumë këtë vit, krahasuar me periudhën e njëjtë raportuese të vitit 2017.

Një arsytim që e keni dhënë, për mua nuk është i arsyeshëm, ku thuhet se: “vlen të theksohet se kemi më pak shpenzime se vitin e kaluar në këto kode ekonomike: <furnizimi me ushqim dhe pije>, <karburant për vetura>, <regjistrimi i automjeteve, sigurim i automjeteve, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve>, <drekat zyrtare> etj”. Nga të gjitha këto kode ekonomike, vetëm tek <drekat zyrtare> keni shpenzime më pak dhe për këtë, Klinaku tha se iu përgëzoj, kurse tek çështja e automjeteve, keni pasur mundësi të keni shpenzime më pak, për shkak se keni marrë automjete me qira, por ka ndodh e kundërta, keni shpenzime më shumë, kështu që lidhur me këto çështje që i ngriti, Klinaku kërkoi sqarime.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit për këtë periudhë janë për afër 30,000.00 € dhe kjo është një shifër enorme e shpenzimit, ku për këtë kërkoi që të ndalet keqpërdorimi i parasë publike. Lidhur me këto shpenzime galoponte, ai ilustroi me një shembull ku ceku se Kryetari i Komunës së Skënderajt prej se ka ardhur në krye të komunës ka shpenzuar rreth 2000 € për udhëtimet jashtë vendit, dhe nga këto takime ai i ka sjellë benefite komunës së tij. Andaj lidhur me këtë ai kërkoi përgjigje me shkrim se çfarë ka përfituar Komuna e Vushtrrisë nga takimet që menaxhmenti komunal me në krye kryetarin e komunës që ka realizuar në botën e jashtme, ku janë shpenzuar dhjetëra mijëra euro të qytetarëve të komunës. Pastaj shtoi se ky nëntëmujor karakterizohet me një performancë jashtëzakonisht të dobët të qeverisë komunale sepse sipas planifikimit buxhetor qeveria ka pasur në dispozicion mbi 5 milionë euro për projekte kapitale, dhe prej këtyre kjo qeveri ka arritur të realizojë 1,400.000.00 € ose shprehur në përqindje realizmi i buxhetit për kategorinë e investimeve kapitale është bërë në masën 26 %, dhe kjo na bie deri tek përfundimi se qeveria aktuale edhe nëse do ta ketë shkopin magjik se nuk do të mundet t’i shpenzoj mbi 4 milionë euro për këta 3 muaj të këtij viti që po e lëmë pas, dhe sipas kësaj dinamike me siguri se këto para do të shkojnë si suficit në Qeverinë e Kosovës. Auditori i përgjithshëm ka dhënë vërejtje në raport për siç thuhet shpenzim të parasë në kundërshtim me projeksionet buxhetore, dhe në këtë kontekst ekziston edhe një rrezik tjetër, që qeveria komunale në këtë fundvit tenton t’i rris shpenzimet me qëllim të përmirësimit të performancës dhe kështu rrezikohet shpenzimi i buxhetit në mënyrë joadekuate dhe për shërbime që ndoshta nuk janë shumë të nevojshme për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë. Andaj si përfundim i krejt kësaj, vlerësoi se kjo qeveri është qeveri e dështuar, e cila në fund të këtij viti do ta dëmtojë qytetarin me mosrealizim të projekteve kapitale dhe mosofrim të shërbimeve të nevojshme, ku komuna do të ballafaqohet me suficit buxhetor dhe paratë do të shkojnë në nivelin qendror, kjo është rezultat i paaftësisë dhe menaxhimit jashtëzakonisht të dobët të kësaj qeverie.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës -tha se me buxheti i planifikuar do të shpenzohet në tërësi dhe për këtë i siguroi anëtarët e kuvendit. Pastaj ai ceku se nuk dëshiron të lëshohet në diskutime politike dhe gjërat profesionale t’i politizojë, duke shtuar se për të gjithë ata që kanë brenge i siguroj se koalicioni qeverisë në Vushtri është duke funksionuar shumë mirë.

Lutfi Gurguri, drejtor i DBF-së - paraqiti sqarime lidhur me raportin në fjalë, duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit. Në referimin e tij para kuvendit, bëri të ditur faktorët të cilët kanë ndikuar në performancën jo të mirë në inkasimin e të hyrave vetanake të komunës. Mandej ai ceku se në disa drejtori komunale janë hequr disa taksa dhe kjo ka ndikuar në uljen e inkasimit, por marrë në tërësi buxheti është pozitiv krahasuar me vitin e

kaluar. Lidhur me shpenzimet vlerësoi se këtë vit janë rritur ato pasi që janë krijuar disa shpenzime që vitin e kaluar nuk kanë qenë, ato janë: shpenzimet e varrimit, shpenzimet për kompaninë “Uniteti”, transporti i nxënësve, si dhe vendimet gjyqësore, të gjitha këto kanë ndikuar në rritjen e shpenzimeve krahasuar me vitin e kaluar.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - tha se pavarësisht shpenzimeve që janë krijuar e që vitin e kaluar nuk kanë qenë, prapëseprapë kjo qeveri në të hyrat vetanake ka realizuar për 326,000.00 € më pak të hyra se sa vitin e kaluar, dhe kjo bie ndesh me premtimet elektorale që kishte dhënë kryetari i komunës gjatë kampanjës paraelektorale. Premtimi i kryetarit të komunës gjatë fushatës ka qenë që pikërisht nga kursimi i mjeteve financiare nga mallrat dhe shërbimet do të punësohen nga 100 persona, dhe tash po del e kundërta sepse shpenzimet jo që janë zbritur, por ato janë rritur krahasuar me vitin e kaluar me qeverisjen e vjetër.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota unanime aprovoi raportin janar-shtator 2018 për të hyrat dhe shpenzimet.

8. Shqyrtimi i Draft-rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2019

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - paraqiti vërejtjet e tij sa i përket pjesës hyrëse apo thirrjeve juridike, të kësaj draft-rregulloreje, për faktin se hartuesi referohet shembull: nenit 12.1 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e që në fakt nuk ka nen 12.1, por ka nen 12, mandej vinë paragrafët me radhë. Andaj lidhur me këtë ai i sugjeroi hartuesit e materialeve që shqyrtohen në kuvend që paraprakisht ato të filtrohen në zyrën ligjore të komunës, para se ato të procedohen në kuvend. Pastaj duke iu referuar nenit 7 të kësaj draft-rregulloreje ku thuhet se: kriter për vlerësimin e pronës dhe caktimin e bazës tatimore në këtë rregullore do të merret nenit 13 i Ligjit nr.03/L-204, ligj ky që tashmë është shfuqizuar nga ligji i ri i cili ka hyrë në fuqi. Gjithashtu ai propozoi që në këtë draft-rregullore të shtohet një nen i ri që tatimpaguesit t'i jap të drejtën e ankesës.

Ermal Lahu, anëtar i kuvendit - duke iu referuar nenit 9 të draft-rregullores në fjalë, ku ceket se pagesa e tatimit në pronë bëhet në dy këste të barabarta dhe atë kësti i parë deri më 30 prill dhe kësti i dytë më së largu deri me 30 shtator të vitit tatimor. Këtu kemi një ndryshim krahasuar me rregulloren e kaluar, dhe kjo mund të krijojë huti tek qytetarët gjegjësisht tatimpaguesit, andaj për këtë kërkoi që të kemi një informim sa më të mirë të qytetarëve sepse në të kundërtën tejkalimi i këtyre afateve mund të shkaktojë akordimin e kamatës dënuese ndaj qytetarëve.

Gjylsime Feka, zyrtare në Drejtorinë për Buxhet - paraqiti sqarime lidhur me Draft-rregulloren e tatimit në pronë, duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Sami Istrefi, anëtar i kuvendit - tha se janë vetëm disa kritere të cilat nuk mund të ndryshohen në këtë draft-rregullore, për shkak se ligji i precizon ato, ndërsa temat tjera mund të diskutohen dhe për këtë është i nevojshëm mbajtja e diskutimit publik.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se kjo draft-rregullore është dashur të aprovohet para aprovimit të buxhetit të komunës ose ekuivalent me aprovimin e buxhetit, andaj procedimi i tillë nuk është në rregull. Ai shtoi se është kërkesë e ligjit që për çdo pesë vite duhet të bëhet komisioni për vlerësimin e vlerës së objekteve që tatimohen, dhe për këtë rregullore duhet të mbahen dëgjime apo diskutim me qytetarë.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 25 vota “për” 2 vota “kundër” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

- 1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Tatim në Pronën e Paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2019.**

2. Diskutimi publik fillon nga data 1 nëntor 2018 dhe zgjat deri më 15 nëntor 2018.

3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmarrë masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.

4. Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që si propozues i draft-rregullores në fjalë, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2015 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet drejtoria e sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin nëntor 2018.

9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpallje të ankandit publik

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se si grup kuvendar e mbështesin këtë pikë të rendit të ditës, pasi që shitja e këtyre mjeteve motorike të vjetruara, ka inpakt pozitiv në uljen e shpenzimeve komunale në mirëmbajtje të automjeteve dhe kjo ndikon në kursimin e buxhetit të komunës.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - paraqiti vërejtje për siç tha shkresat të cilat procedohen në kuvend, janë ta pastandardizuara, dhe ato dallojnë nga njëra tek drejtoria tjetër që është hartues i tyre. Lidhur me propozim-vendimin për shpallje të ankandit publik, ceku se ai ka mangësi sa i përket thirrjeve juridike, dhe për këtë ceku se materialet duhet të filtrohen nga zyra ligjore e komunës.

Sami Istrefi, anëtar i kuvendit - pyeti se pas përfundimit të kontratës së lizingut për automjetet të cilat i ka marrë komuna, këto automjete në pronësisë e kujt do të mbesin, në pronësi të komunës apo të qiradhënësit.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet shpallja e ankandit publik për shitjen e mjeteve motorike të autoparkut të komunës, të cilat për shkak të vjetërsisë kanë kosto të lartë të shpenzimit të karburanteve dhe mirëmbajtjes. Mjetet motorike të cilat do t'i nënshtrohen ankandit publik janë si në vijim:

- 1.1. RENO CLIO me Nr. të tabelave 02Z-05-27;**
- 1.2. MITSUBISHI PAJERO me Nr. të tabelave 02Z-06-27;**
- 1.3. TOYOTA RUNER me Nr. të tabelave 02Z-19-27;**
- 1.4. TOYOTA RUNER me Nr. të tabelave 02Z-17-27;**
- 1.5. TOYOTA RUNER me Nr. të tabelave 02Z-17-27;**
- 1.6. TOYOTA RUNER me Nr. të tabelave 531-KS-065;**
- 1.7. NISAN PATROL me Nr. të tabelave 02Z-33-27;**
- 1.8. NISAN PATROL me Nr. të tabelave 02Z-08-27;**
- 1.9. TOYOTA RUNER me Nr. të tabelave 02Z-23-27;**
- 1.10. TOYOTA HILUKS me Nr. të tabelave 02-674-AA;**
- 1.11. VOLGSWAGEN VENTO me Nr. të tabelave 02-396-AR.**

2. Autorizohet Kryetari i komunës që të themelojë komisionin profesional për caktimin e vlerës fillestare të materialit, ndërsa organi kompetent i komunës të zbatojë procedurat e shitjes përmes ankandit publik.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtorja e Prokurimit, si dhe Drejtorja për Shërbime Publike.

10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës pa kompensim, KRM “Uniteti”, SH.A. Njësia në Vushtrri

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se si grup kuvendar janë që të përkrahet Kompania “Uniteti”. Por megjithëkëtë duhet ditur se kompania në fjalë është kompani publike shoqëri aksionare, nuk është organizatë qeveritare, nuk është në rangun e organizatave ku komuna ka të drejtë të jap pronë pa qira (kompensim), dhe në këtë kontekst me siguri që këtë vendim ministria do të kthejë prapa. Parimisht si grup janë që ky vendim të aprovohet edhe pse vlerëson se ky propozim-vendim është kundërligjor sepse ligji i përcakton procedurat të cilat duhet të ndiqen në rastin e dhënies së pronës në shfrytëzim.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - tha se si Lëvizje për Bashkim, janë kundër këtij propozim-vendimi pasi që ai është kundërligjor dhe si të tillë si subjekt politik nuk mbështesin diçka që është kundër ligjit. Mandej ai në referim të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme, ceku se ndalohet dhënia në shfrytëzim pa kompensim dhe për këtë ata do të votojnë kundër këtij propozim-vendimi.

Sami Istrefi, anëtar i kuvendit - tha se atë që deklaroi z.Klinaku nuk qëndron sepse ligji lejon që prona të jepet pa kompensim në raste të caktuara, sepse njëjtë është vepruar edhe më herët, por për këtë nevojitet një pëlqim apo kërkesë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, pasi ajo menaxhon me ndërmarrjet publike. Në fund ai kërkoi që krahas caktimit të kësaj hapësire, për ndërtimin e këtyre stabilimenteve, të trajtohet edhe deponia që gjendet aty afër e cila kundërmon së tepërmi.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - insistoi se në saje të kërkesës së bërë nga njësia e Kompanisë “Uniteti” në Vushtrri kuvendi nuk ka të dejtë të japë pronë në shfrytëzim. Kjo është dashur të bëhet me kërkesë nga kompania “Uniteti” qendra në Mitrovicë, përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se dallon statusi juridik i KRM “Unitetit” dhe Ndërmarrjes Ujësjetësi për faktin se kjo e fundit është ndërmarrje publike me të cilën menaxhon Ministria e Zhvillimit Ekonomik, kurse KRM “Uniteti” është shoqëri aksionare ku aksione në të ka edhe Komuna e Vushtrrisë. Dhe kështu në këtë formë janë dy gjëra të ndryshme ku KRM “Uniteti” është kompani e nivelit lokal për të cilën nuk mund të jap pëlqim niveli qendror, dhe në këtë rast kuvendi nuk mund t’i japë pronë në shfrytëzim pa i përfillur procedurat e ankandit dhe të konkurrencës.

Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së - tha se para se të hartohet ky propozim-vendim janë bërë konsultat e nevojshme dhe të duhura, dhe për këtë çështje kemi pasur disa kërkesa nga kompania që iu janë drejtuar komunës për caktimin e një lokacioni (parcele) për ndërtimin e objektit për nevojat e kompanisë “Uniteti”. Lidhur me ligjshmërinë e këtij vendimi vlerësoi se nëse ka diçka kundërligjore, atëherë këtë do ta konstatojë Ministria e Pushtetit Lokal.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - përsëriti se kjo çështje është kundërligjore, dhe është e çuditshme përpjekja që në këto forma të tentohet të votohet ky propozim-vendim, kur të gjithë e dinë dhe janë të sigurt se kjo çështje nuk është në pajtim me ligjin.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 14 vota “për” 1 votë “kundër” dhe 10 vota “abstenim” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim jepet në shfrytëzim pa kompensim, pjesë nga parcela P-70202016-04865K-1, ZK-Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë, në sipërfaqe prej 651 m², nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës prej 8890 m².

2. Paluajtshmëria e cekur në nenin 1 të këtij vendimi i jepet në shfrytëzimin pa kompensim, në afat prej 99 vitesh, KRM “Uniteti” SH.A. (shoqëri aksionare), Njësia Vushtrri, për ndërtimin e objektit për nevoja të kompanisë.

3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

4.Pjesë përbërëse e këtij vendimi është certifikata e pronës dhe kopja e planit.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin e vendimit të kuvendit Nr.115/18 i datës 26.04.2018

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim plotësohet dhe ndryshohet pika 1 e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë Nr.115/18 i datës 26.4.2018 dhe riformulohet si teksti në vijim: ”Me këtë vendim lejohet hartimi i Strategjisë të Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Vushtrrisë për periudhën 2019-2023”.

2.Pjesët tjera të vendimit mbesin të pandryshuara.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës dhe Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për plotësimin e vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës për Qendrën Ditore për Fëmijët me Nevoja të Veçanta në fshatin Nedakoc

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim, lejohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme të komunës - Qendra për Qëndrim Ditor për Fëmijë me Nevoja të Veçanta në fshatin Nedakoc dhe hapësirës së nevojshme përreth objektit, e cila gjendet në ngastrën kadastrale P-70202043-0011-1, në sipërfaqe prej 1109 m² (objekti dhe sipërfaqja përreth objektit), Zona Kadastrale Nedakoc.

2.Prona e paluajtshme e cekur në pikën 1 të këtij vendimi jepet në shfrytëzim afatshkurtër, pa kompensim, në kohëzgjatje prej pesë (5) vitesh, Organizatës joqeveritare të specializuar për ofrim të shërbimeve profesionale për fëmijë me nevoja të veçanta.

3.Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të bëjë regjistrimin e paluajtshmërisë e cila jepet në shfrytëzim, në regjistrin kadastral.

4.Obligohet Komisioni për vlerësim të ofertës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, që të zhvillojë procedurat për shpalljen e ankandit publik dhe përzgjedh ofertën më të përshtatshme, të cilën ia dërgon Kryetarit të komunës për lidhje të kontratës.

5.Komuna rezervon të drejtën që në çdo kohë të shkëpusë në mënyrë të njëanshme kontratën nëse një gjë të tillë e kërkon interesi i përgjithshëm.

6.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

13. Shqyrtimi i propozim vendimit për rialokimin e mjeteve financiare të Komunës së Vushtrrisë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim lejohet rialokimi i mjeteve buxhetore “Projektet me bashkëfinancim me donatorë”, nga kodi 43900 i Drejtorisë së Shërbimeve Publike për nevojat e Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësisë, Pylltari dhe Zhvillimit Rural, për pagesë të shumës prej 3,640.00 € sipas marrëveshjes për bashkëpunim në mes Komunës së Vushtrrisë dhe IADK-së sipas Aneksit I për vitin 2018.

2.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, si dhe Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

14. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore që evidentohet në emër të Ermira/Bedri/Osmani

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - tha se e përkrahin këtë propozim-vendim, por kërkoi që propozim-vendimeve të kësaj natyre t’u bashkëngjiten ortofotot.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, në parcelën kadastrale P-70202025-00267-0 me kulturë arë e klasës së pestë (5), Zona Kadastrale Dolak me sipërfaqe të përgjithshme prej 8872m², nga e cila kërkohet për shndërrim sipërfaqja prej 425m², e cila evidentohet në emër të Ermira (Bedri) Osmani pronare e 1/1 të pjesës së ngastrës të cekur më lart.

2. Qëllimi i lejimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në vendin e quajtur „Umishte na bregu” në parcelën kadastrale të cekur si në pikën një të këtij vendimi është ndërtimi i objektit ekonomik-bujqësor „Fermë për viça”.

3. Lejen ndërtimore dhe kushtet për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit nga pika e dytë do ta lëshojë dhe përcaktojë konform dispozitave ligjore Drejtoria për Urbanizëm Mbrojtje të Mjedisit, pas pagesës së tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore.

4. Obligohet pronari i parcelës nga pika 1 e këtij vendimi që të bëjë pagesën e tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore sipas nenit 14.2 në „b” të Udhëzimit administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore Nr. 41/2006 përmes Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

5. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikata e pronësisë dhe kopja e planit.

6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

15. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore që evidentohet në emër të Mehdi Bilallit

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, në parcelën kadastrale me Nr.P-70202050-01189-0 me kulturë arë e klasës së gjashtë (6), Zona kadastrale Sumë, me sipërfaqe të përgjithshme prej 10274m² nga e cila kërkohet për shndërrim sipërfaqja prej 864.758 m², Mehdi Bilalli shfrytëzues i ngastrës, bazuar në aktin noterial LRP.Nr. rendor 3722/2018 me nr. reference 100/2018 në cilësinë e qiramarrësit.

2. Qëllimi i lejimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në vendin e quajtur „Milivadhe” në parcelën kadastrale të cekur si në pikën një të këtij vendimi, është ndërtimi i objektit „Objekt ekonomik bujqësor - shtallë për rritjen e bikave”.

3. Lejen ndërtimore dhe kushtet për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit nga pika e dytë do ta lëshojë dhe përcaktojë konform dispozitave ligjore Drejtoria për Urbanizëm Mbrojtje të Mjedisit, pas pagesës së tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore.

4. Obligohet pronari i parcelës nga pika 1 e këtij vendimi që të bëjë pagesën e tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore sipas nenit 14.2 në „b” të Udhëzimit administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore Nr. 41/2006, përmes Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

5. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikata e pronësisë dhe kopja e planit.

6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

7. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

16. Shqyrtimi i kërkesës për rishqyrtimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me Nr.23/18 i datës 25. 01.2018 për themelimin e KPF-së

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se grupi kuvendar i PDK-së edhe atëherë nuk ishte pajtuar me formën si ishte votuar për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, pasi nuk ishte respektuar kuota gjinore, dhe për këtë kishte kundërshtuar. Tutje shtoi se jo zyrtarisht tani janë informuar se ndaj Komunës së Vushtrrisë është ushtruar një padi nga ana e Ministrisë së Drejtësisë për mosrespektim të kuotës gjinore sa i përket strukturës së KPF-së. Lidhur me këtë vlerësoi se tani duhet pritur deri në epilogun gjyqësor të kësaj çështjeje.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit – njoftoi kuvendin se nëse bëhen ndryshimet e duhura në strukturën e Komitetit për Politikë dhe Financa, atëherë ministria gjegjëse do ta tërheq padinë ndaj Komunës së Vushtrrisë.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - vlerësoi se padia nga Ministria e Drejtësisë, është politike për faktin se po punohet me shumë standarde sepse kemi komunë në Republikën e Kosovës, që Komitetin për Politikë dhe Financa i ka 7 anëtarë dhe që të gjithë janë të gjinisë mashkullore dhe ndaj kësaj komune nuk ushtrohet padi. Lidhur me këtë ai ceku se kuota prej 30 % sipas ligjit të zgjedhjeve është plotësuar andaj apeloj që ky vendim të mbetet ashtu qysh është aktualisht.

Sami Istrefi, anëtar i kuvendit - tha se paraprakisht para se të vjen kjo shkresë nga ministria, është dashur të zhvillohet një debat mes subjekteve politike të përfaqësuara në kuvend, me qëllim që të gjendet një zgjidhje politike për sa i përket respektimit të kuotës gjinore lidhur me strukturën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit - tha se më qëllim që të gjendet një zgjidhje politike sa i përket strukturës së KPF-së, është mirë që të shkohet me një pauzë ku shefat e grupeve kuvendare do të diskutojnë dhe do ta merrnin një vendim.

Ermal Lahu, anëtar i kuvendit - tha se atëherë kur është votuar për çelësin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, është dashur të merren për bazë dispozitat e LVL-së, por edhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.03/2014 për Procedurën e Themelimit dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë ku në nenin 6 thuhet: *Komiteti për Politikë dhe Financa përbëhet nga përfaqësuesit e subjekteve politike që përfaqësohen në kuvendin e komunës, përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteteve politike dhe numrin e ulëseve nga entitetet politike të përfaqësuara në kuvendin e komunës.* Për respektimin e këtyre dispozitave nuk ka pasur vullnet politik, për faktin se KPF ka 9 anëtarë, dhe në kuvendin e komunës janë të përfaqësuara 9 entitete politike, gjë që është dashur që në KPF të përfaqësohet secili subjekt me nga 1 anëtar.

Në vazhdim kuvendin mori një pauzë me qëllim të diskutimit për gjetjen e një zgjidhjeje, lidhur me strukturën gjinore të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pas konsultave të shefave të grupeve kuvendare, kryesuesi i kuvendit konstatoi se nuk pati vullnet politik për arritjen e marrëveshjes lidhur me strukturën gjinore të Komitetit për Politikë dhe Financa, por grupet kuvendare u dakorduan që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës.

17. Të ndryshme

a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve financiare të Komunës së Vushtrrisë

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - kërkoi që të futet në rend të ditës, propozim-vendimi për ridestinimin e mjeteve financiare të Komunës së Vushtrrisë, në vlerë prej 17,500.00 € nga projekti “Inventar për objektin e ri të komunës” me kod 43890, në projektin “Blerja e një gjeneratori elektrik” (projekt i ri). Më tutje arsyetoi se ridestini i këtyre mjeteve është i natyrës urgjente dhe me rëndësi publike, andaj për këtë kërkoi që ky propozim-vendim të aprovet, me qëllim që të mundësohet zhvillimi i procedurave të prokurimit.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - tha se futja në rend të ditës e këtij propozim-vendimi është në kundërshtim me dispozitat e statutit të komunës, pasi që pas aprovimit të rendit të ditës nuk mund të ndryshohet ai duke futur një pikë shtesë. Pastaj shtoi se nëse kjo temë është me rëndësi publike dhe e natyrës urgjente, atëherë për këtë mund të mbahet një mbledhje urgjente sipas procedurave që i parasheh legjislacioni në fuqi. Në të kundërtën nëse kështu votohet, atëherë ky vendim ka mundësi që të kthehet si i kundërligjshëm nga ana e MAPL-së.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se si grup kuvendar nuk janë të pajtimit me futjen në rend të ditës të këtij propozim-vendimi, pasi pikat shtesë nuk lejohen të futen në rend të ditës pas aprovimit të rendit të ditës. Por megjithëkëtë pasi që situata është emergjente, atëherë do ta votojnë këtë propozim-vendim konform ligjit.

Pas shqyrtimit të këtij propozim-vendimi, kuvendi me 20 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi që ta fut në rend të ditës Propozim-vendimin për ridestinimin e mjeteve financiare të Komunës së Vushtrrisë.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 23 vota “për” 3 vota “abstenim” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim bëhet ridestini i mjeteve financiare në vlerë prej 17,500.00 € nga projekti “Inventar për objektin e ri të komunës” me kod 43890, në projektin “Blerja e një gjeneratori elektrik” (projekt i ri).

2.Ridestini bëhet në kuadër të programit të njëjtë në Drejtorinë e Administratës me kod 16324.

3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria e Administratës.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në ora 15:30.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit

